

STATUT I SHOQERISE "CODE LAB" Sh.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtua.

Sot, më 20/01/2025, personat e mëposhtëm:

Z. Enis Ifti, shtetas shqiptar, lindur më 26/07/1995 në Tiranë (ALB) e banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J50726076J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z.Regji Mele, shtetas shqiptar, lindur më 09/08/2002 në Gjirokastër (ALB) e banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. K20809037U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

në përputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoi këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 20 Janar 2025 ne, themeluesit e mësipërm, vendosëm të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar "**CODE LAB**" SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria do të ketë si aktivitet: Disenjim software-i. Përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekture dhe projektimi i detajuar i sistemit software. Disenjim i automatizimit të proceseve të sistemeve të ndryshme. Zhvillim dhe mirembajtje të sistemeve software. Përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim). Disenjim dhe mirembajtje të sistemeve raportuese si Business Intelligence. Përfshihet përmirësimi, mirembajtja dhe testimi i tyre. Testim software. Përfshihet testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të

disponueshmerise dhe te sigurise se sistemit software. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Dizenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Ketu perfshihet analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurise dhe mirembajtja perkatese. Zhvillim sistemesh migrimi. Ketu perfshihet transferimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re. Permiresim/upgrade sistemesh informatike. Operimi, menaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. Dizenjimi, implementimi, mirembajtja e sistemeve te database dhe data warehouse, siguria tyre dhe transferimi i te dhenave ndermjet tyre. Konsulence ne sektorin e IT dhe programimit. Sherbim/konsulence marketing dhe SEO (search engine optimization). Shoqeria mund te kryeje edhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtetin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

Neni 4 Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Besnik Sykja", njësia bashkiake nr 2, ndërtesa nr 6, hyrja nr 2, kati i parë, Tiranë.

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra perfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.


Kreu II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10000 Leke (dhjetë mijë leke), i ndarë si më poshtë:

- a. **Enis Ifti**, mbajtës i një kuote që perfaqëson 50% të kapitalit me vlerë 5000 lekë (pesëmijë lekë);
- b. **Regi Mele**, mbajtës i një kuote që perfaqëson 50% të kapitalit me vlerë 5000 lekë (pesëmijë lekë);

Kontributi i ortakeve te paguhet nga ana e tyre, sipas vendimit te organit administrativ.



Pergjegjësia e Ortakeve per detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuatat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj. Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet te gjallëve duhet te bëhet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Ne rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtpërblim, ortakët e tjerë kanë të drejtë e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;

j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Për sa kohë që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtrojë kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përfashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënie ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria do të ketë dy administratorë të cilët janë:

Z. Enis Ifti, shtetas shqiptar, lindur më 26/07/1995 në Tiranë (ALB) e banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. J50726076J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Z. Regi Mele, shtetas shqiptar, lindur më 09/08/2002 në Gjirokastrë (ALB) e banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. K20809037U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Të dy administratorët mund të veprojnë vecmas nga njëri tjetri në mënyrë të pavarur me të drejta të plota, në çdo institucion publik ose privat si DRT, Bashki, çdo bankë të nivelit të Dytë si dhe përpara institucioneve të tjera të pushtetit qendror dhe lokal etj.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertët

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15 **Ekspertet**

Ekspteri ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

Neni 16 **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës. Ne këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri ne likuidim e sipër”. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17 **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19


Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkruan nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT THEMELUES SË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "CODE LAB"

Enis Ifti

Enis Ifti


Regi Mele

Regi Mele
